



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.Dh.Sh.II.nr.1042/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit G&G Furniture DOOEL me seli në Maqedoninë Veriore – Tetovë, Rr. “Kusman Josifovski” nr.53, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat V.M. me seli të zyrës në Ferizaj, kundër debitorit Sanerd Sh.p.k, me numër unik identifikues 811455543 me seli në Prishtinë, Rr. “Don Shtjefan” p.n., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat V.B. me seli të zyrës në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1946/22 të datës 29.06.2023, me datë 15.12.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të kreditorit G&G Furniture DOOEL, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1946/22 të datës 29.06.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1946/22 të datës 29.06.2023, në pikën I të dispozitivit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit të Sanerd Sh.p.k, të ushtruar kundër Urdhrit për Përmbartim P.nr.409/22 të dt. 29.11.2021 të Përmbartuesit Privat Sheremet Livoreka.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përbarimore, me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1946/22 të datës 29.06.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Debitori nuk ka paraqit përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të autorizuarit të kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori G&G Furniture DOOEL me datën 29.11.2022 ka paraqitur propozimin për përbarim në bazë të dokumentit të besueshëm ë bazë të dokumenteve të besueshme si ne vijim: Fatura nr.01/2020 dt. 29.09.2020; Fatura nr. 02/2020 dt. 29.09.2020; Fatura nr. 03/2020 dt. 29.09.2020 si dhe CMR 0267942, CMR 0267943 dhe CMR 0189692 për shumën e borxhit në lartësi 111,166.00€ (njëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë euro), me kamatë vonese 8%, deri në pagesën e plotë, si dhe shpenzimet e përbarimit, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Debitori ka paraqitur prapësim brenda afatit ligjor, me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin për përbarim, për shkak të cenimit të rregullave të procedurës përbarimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Bazën ligjore të prapësimit e ka mbështetur në nenin 71 par. 1.1 të LPP-së, për çka ka theksuar se dokumenteve të besueshme si në këtë çështje u mungojnë tiparet e përbarueshmërisë, konkretisht faturat si dokumente të besueshme nuk janë pranuar dhe nuk janë nënshkruar e as vulosur nga ana e debitorit të përbarimit. Meqenëse nuk janë përmbushur elementet nga neni 22, 29 dhe 38 i LPP-së, i ka propozuar gjykatës që të aprovet prapësimi i debitorit në tërësi i bazuar, të anulohet dhe shfuqizohet në mënyrë të plotë urdhri për përbarim dhe të obligohet kreditori që t'i bartë shpenzimet përbarimore në tërësi.

Kreditori ka parashtruar përgjigje ndaj prapësimit të debitorit, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi prapësimin në fjalë, duke theksuar se faturat janë të shoqëruara me CMR përkatëse, të cilat kanë shërbyer si dëshmi verifikimi me hyrjen e mallit në Doganën e Kosovës, ndërkaq faturat janë regjistruar nga vetë debitori në ATK për realizimin e të drejtave të tij tatimore. Tutje kreditori ka theksuar se qëllimi i debitorit me prapësim është vetëm që të zvarrisë procedurën dhe të mënjanojë përmbushjen e detyrimeve.

Gjykata Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1946/22 të datës 29.06.2023, në pikën I të dispozitivit ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit të Sanerd Sh.p.k, të ushtruar kundër Urdhrit për Përmbarim P.nr.409/22 të dt. 29.11.2021 të Përmbaruesit Privat Sheremet Livoreka.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se faturat e lëshuara nga kreditori ndonëse janë të paraqitura në origjinal ato nuk kanë asnjë të dhënë sa i përket faktit se debitori i ka pranuar të njëjtat – qoftë me vulë të subjektit juridik qoftë me nënshkrim nga personi i autorizuar, sepse asnjëra nga faturat nuk përmban as vulë e as nënshkrim përkatës nga debitori. Nga ky konstatim për gjykatën mbetet e paqartë rrethana apo fakti nëse debitori është shërbyer me këto fatura në mënyrë të rregullt dhe sipas ligjit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturës se lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshme për përmbarim po që se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe

gjkata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata e shkallës e dytë bazuar në Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili në nenin 20 par.1 në par.1.17 parasheh që *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*, konsideron se faturat si dokumente në sajë të cilave kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, nuk ka prova se janë pranuar nga debitori, të njëjtat nuk janë të vullosura e as nënshkruara nga debitori në mënyrë që të konsiderohen si dokument i besueshëm.

Pretendimi ankimor i kreditorit se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave kur ka vendosur mbi mospranimin e faturës nga ana e debitorit, pasi që faturat janë të shoqëruara me CMR të cilat dëshmojnë se malli ka hyrë nëpërmjet Doganës së Kosovës në sasi dhe copë dhe të njëjtat janë të regjistruara në ATK, Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë një pretendim të tillë nuk mund ta pranoj si të bazuar, ngase sipas dispozitave të lartcekura faturat duhet të jenë të nënshkruar. Në rastin konkret faturat nuk janë të nënshkruara nga ana e debitorit dhe si të tilla nuk mund të pranohen si dokument i besueshëm, në bazë të cilave mund të zhvillohet procedura përbarimore, mirëpo kreditori mund të inicioj procedurë tjetër gjyqësore lidhur me realizimin e kërkesës së tij varësisht sipas suksesit në atë procedurë.

Dhomat e Shkallës së Dytë i trajtoi edhe pretendimet ankimore dhe atë në parashtresën mbi dorëzimin e provave në ankesë të datës 29.08.2023 mirëpo vlerësoi se provat e bashkangjitura me ankesë nuk mund të merren në trajtim për shqyrtimin e fakteve të cilat pala është dashur t’ia provojë gjykatës së shkallës së parë, ashtu sipas nenit 180 par.1 të LPK-së parashihet se *“Në ankesë nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të propozohen prova të reja, përveç se kur ankuesi jep prova se pa fajin e vet nuk ka mundur t’i paraqesë, përkatësisht t’i propozojë gjer në përfundimin e shqyrtimit kryesor në gjykatën e shkallës së parë”*.

Në një gjendje të tillë të çështjes, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka marr vendimin e ankimuar pikërisht mbi bazën e materialit të cilin vet kreditori ia ka bashkangjitur ankesës. Rrjedhimisht, në trajtimin e fakteve të çështjes dhe rrethanave të rastit,

gjykata e shkallës së parë ka vendosur sipas propozimit vetëm mbi bazën e asaj që ka pasur në dispozicion me propozimin e parashtruar. Ndërkaq, parashtrimi i provave të reja me ankesë në gjykatën e shkallës së dytë, duke mbështetur faktet e pretenduara, nuk mund të merret parasysh në procedurën e ankesës për të kontestuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se me faktin se kreditori ka iniciuar procedurën përmbarimore nënkupton se ka pasur në dispozicion provat shtesë, të cilat nuk ia ka bashkangjitur me kohë propozimit. Prandaj, gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur të vendosë ndryshe lidhur me faktet për të cilat nuk ka pasur njohuri, kurse provat e reja me ankesë nuk mund të parashtrohen për të kontestuar faktet të cilat pala i ka pasur të njohura dhe për provat të cilat i ka pasur në dispozicion. Së fundi, kreditori nuk ka dhënë arsye nëse eventualisht pa fajin e vet nuk ka arritur t'i paraqesë provat – çka nënkupton se lëshimet në të provuarit e fakteve nuk mund t'i atribuohen gjykatës së faktit.

Nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë. Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë

EK.nr.1042/23 me datë 15.12.2023

Gjyqtarja,
Frnaciska Zhitija-Ymeri